

# Nga shkolla ... në shtëpi!




Ushtrime-lojra  
për prindër e  
fëmijë

## Pyetje:

Ç'të përbashkët kanë: programimi i punëve tona javore apo mujore, komunikimet tona telefonike, përdorimi i sahatit me rërë dhe rritja e vazhdueshme e gjatësisë së fëmijëve?

(Përgjigjja në fq. 4!)



## Brenda në shtëpi...

Çdo shtëpi është e mbushur me sende dhe objekte që mund të përdoren për të lehtësuar dhe për të mbështetur të mësuarit dhe zhvillimin e aftësive gjuhësore, shoqërore, ndjesore, matematikore, etj. të fëmijëve. Shumë nga këto sende dhe objekte ne, të rriturit, i përdorim çdo ditë pa menduar mundësinë që na japin për të luajtur, për të dialoguar apo për të bërë aktivitete të ndryshme me fëmijët e moshës parashkollore.




## Ide për aktivitete


Më poshtë ndjekin disa ide për mënyrat me të cilat familja - prindërit, gjyshet dhe gjyshërit - mund të përfshijë fëmijët në atë që quajmë «çaste mësimi». Bëhet fjalë për çaste të së përditshmes ku nuk ka nevojë për presion, për dije dhe aftësi të veçanta nga ana e të rriturit dhe ku fëmijët mësojnë në mënyrë të këndshme. Thjesht, shfrytëzojmë ato që bëjmë çdo ditë me apo pa objekte shtëpie!

## Kalendar muri

---



Në një kalendar (muor dhe më mirë muri) shënoni takimet tuaja, festat që ju interesojnë, ditëlindjet e anëtarëve të familjes apo datat më të rëndësishme për ju. Inkurajoni, gjithashtu, fëmijën tuaj të «shënojë» edhe ai aktivitetet e tij, (p.sh. festën e një shoku) apo çfarëdo tjetër dëshiron të mbajë mend me çdo kusht, (mund të përdorë «simbole» të ndryshme, p.sh. një tortë për festën e ardhshme, ose emrin e shokut që bën festën etj.). Në rastin më të parë pyesni veten «me zë» në prezencë të fëmijës: «Vallë, sa ditë duhet të kalojnë derisa të...?» dhe numëroni bashkë me fëmijën.




## Telefoni dhe numratori i telefonave

---

Sa herë që kërkoni ndonjë emër në numratorin e telefonave (në atë personal apo në atë lokal), ftoni fëmijën tuaj t'ju ndihmojë të gjeni gërmën me të cilën fillon emri që kërkoni. Do të funksiononi si model për të nëse i tregoni si vepron për të kërkuar dhe për të gjetur emrin konkret (p.sh. «Pa të mendohemi nga cila gërmë fillon emri i tij...»). Kërkojini të shënojë numrin e telefonit që gjetët. Mbani mend se çdo herë që fëmija juaj ju shikon të shënoni ndonjë informacion që ju japin në telefon, i tregoni menjëherë rëndësinë e të shkruarit në jetën tonë të përditshme. Kur doni të telefononi diku, i propozoni fëmijës suaj të formojë numrat që do t'i thoni. Në fillim i thoni numrat një e nga një (p.sh. dy, një, pesë, tetë...), më vonë provoni dhe dyshifrorët (p.sh. njëzet e dy, pesëmbëdhjetë...).



## Ora dhe sahati me rërë (ose me lëng)





Nëse përdorni sahat me rërë (ose me lëng) në kuzhinë, i theksoni fëmijës faktin se kjo është një tjetër mënyrë matjeje kohe. Sahati me rërë (ose me lëng) është një mënyrë shumë e mirë për të ndihmuar fëmijët të kontrollojnë kohën e një aktiviteti dhe të fillojnë të kuptojnë 'kohëzgjatjen' e një veprimi. Për shembull, nëse vonohet për t'u bërë gati për në shkollë, ose për të fjetur, luani me sahatin me rërë, (p.sh. «Pa të shohim nëse do të bëhesh gati derisa të mbarojë rëra apo lëngu i sahatit»). Kur luani bashkë një lojë, merrni edhe sahatin me rërë (ose me lëng) dhe i propozoni fëmijës suaj të vëzhgojë sa herë do të mbushet apo do të zbrazet sahati derisa të mbarojë loja.

Ora ndihmon në njohjen e numrave dhe familjarizon fëmijët me një nga mënyrat me të cilat matim kohën. Ndërtoni një orë falso duke prerë një qark prej kartoni të trashë (nga kuti kartoni) dhe dy tregues përsëri prej kartoni. Fiksioni treguesit në qendër të qarkut me një kapse dhe shënoni numrat në anë të tij (shih Forma 1). Jepjani fëmijës ta ngjyrosë. Përdoreni atë për të treguar orën ose për të luajtur sëbashku. Për shembull, ai/ajo ju thotë një orë dhe ju i vini treguesit në vendin e duhur. Të njëjtën gjë bën edhe fëmija juaj më pas. Domethënë i thoni: "Ora është 12.00." dhe fëmija duhet të vërë treguesit në vendin e duhur, etj. Më vonë mund të luani dhe me minutat (p.sh.: Pak më parë ora ishte 11.00 dhe kaluan 5 minuta. Ku do ta vëmë treguesin e madh? etj.).



Forma 1.



# Metri & vizorja



Shumë prej nesh kemi në shtëpinë tonë pajisje të ndryshme matjeje të gjatësisë, si: metër, metër shirit apo metër druri, vizore etj. Përdorini ato bashkë me fëmijën tuaj kur doni të bëni matje të ndryshme (p.sh. të matni një copë basme që të qepni një jastëk, të matni dritaren që të llogaritni sa basme nevojitet për perden e re, të matni hapjen e portës që të shikoni nëse mund të kalojë aty një mobilje që doni të lëvizni, etj.). Bëni gjithë procedurën e matjes duke përshkruar çdo veprim tuajin (p.sh. «Tani do të vë fillimin e metrit pikërisht këtu... *pa shiko cilin numër shohim këtu në cep? Zeron. Bukur! Dhe në cepin tjetër, atje ku mbaron dritarja? Një 8-ë dhe një 5-ë... në rregull, kjo dritare ka lartësi 85 centimetër. Le ta shënojmë diku që të mos e harrojmë»).* Përdorni metrin (metrin shirit apo metrin profesional) për matjen e gjatësisë së fëmijës dhe pastaj tuajën apo të pjestarëve të tjerë të familjes. Nëse mundeni t'i shënoni diku matjet tuaja, bëjeni, me qëllim që të riktheheni tek ta në të ardhmen dhe të bëni krahasime (p.sh. «Je zgjatur dy centimetër nga hera e fundit që të mata...»). Keni, gjithashtu, mundësinë të varni një shirit-metër të gjatë letre në ndonjë vend që nuk pengon dhe atje të shënoni matjet tuaja apo i propozoni fëmijës suaj të gjejë një mënyrë të shënojë në të!



## Përgjigjja!

Në të katër rastet, fëmijët, përderisa përdorin kalendarin, sahatin me rërë (apo me lëng), telefonin apo numratorin telefonik dhe metrat, inkurajohen: të përdorin fjalën e folur, të «lexojnë», (p.sh. numrat mbi metër dhe në kalendar, emrat në numratorin telefonik, ditët dhe muajt në kalendar, etj.), të gjejnë mënyra të «shënojnë» (vizatojnë, shkruajnë), të përdorin kuptime matematikore (të familjarizohen me simbolet matematikore, të shohin si përdoren simbolet aritmetike në vegla dhe pajisje të ndryshme, të matin gjatësinë apo kohën, të zgjidhin probleme të thjeshta) dhe të njihen me mënyrën e përdorimit të mjeteve të ndryshme të së përditshmes.



Enti zbatues

**POLIDHROMOS: Grupi dhe Botimi periodik për Dygjuhësinë dhe Shumëkulturën në Arsim dhe në Shoqëri**



[www.polydromo.gr](http://www.polydromo.gr)  
[polydromo@polydromo.gr](mailto:polydromo@polydromo.gr)

Autore teksti

**Maria Papandhreu - Maria Birbili**, Departamenti i Shkencave të Edukimit dhe të Arsimit Parashkollor, Universiteti Aristoteli Selanik

Koordinatorë të programit

**Birbili Maria – Cokalidhu Rula**

Departamenti i Shkencave të Edukimit

dhe të Arsimit Parashkollor, Universiteti Aristoteli Selanik

**Website:** [www.polydromo.gr/dialogos](http://www.polydromo.gr/dialogos)

Përkthyes

**Valbona Hystuna**

Përpunuan tekstin

**Evi Marku**

**Me mbështetjen e**

